



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:264114

Datë: 24.05.2024

Numri i dokumentit: 05730670

K.DH.SH.II.nr.562/24

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS** -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Kompania N.T “Sporting” me numër të biznesit 810577835, me seli në Prizren, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Visar Ostrozubi, avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.18/22 i datës 30.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

## A K T G J Y K I M

**Refuzohet** si e pa bazuar ankesa e paditësit Kompania N.T “Sporting”, me seli në Prizren, e datës 29.11.2023, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.18/22 i datës 30.10.2023, **vërtetohet**.

## A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.18/22 i datës 30.10.2023, Nën pikën I. të dispozitivit të aktgjykimit, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit Kompania N.T “Sporting” me numër të biznesit 810577835, me seli në Prizren, kundër të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit me të cilin ka kërkuar anulimin e vendimit PSH.nr.362/18 të datës 22.08.2018. Ndërsa në pikën II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, për shkak të shkeljeve të dispozitave procedurale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të paditësit N.T.”Sporting” me seli në Prizren, ankesën ta aprovoj si të bazuar ashtu që të priset Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale/ Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.18/22 i datës 30.10.2023 dhe çështja të kthehet në rivendosje në Gjykatën e Shkallës së Parë apo që e njëjta të ndryshohet ashtu që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit N.T. “Sporting” me seli në Prizren, të anulohet vendimi i OSHP-së, vendimi i panelit shqyrtues PSH.nr.362/2018 i datës 22.08.2018, lidhur me çështjen e prokurimit nr. 616-18-008-121 si vendim jo ligjor.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin e kundërshtuar të Panelit Shqyrtues të Prokurimit Publik, PSH.nr.362/2018 i datës 22.08.2018, nën pikën I të dispozitivit të vendimit, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e operatorit ekonomik: NT “Sporting”-Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizimi me rekuizita sportive për shkollat e Komunës së Prishtinës” me nr. prokurimit: 616-18-008-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-

Komuna Prishtinë. Nën pikën II. Vërtetohet njoftimi për dhënie të kontratës me titull: “Furnizimi me rekuizita sportive për shkollat e Komunës së Prishtinës” me nr. prokurimit: 616-18-008-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna Prishtinë. Nën pikën III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit. Nën pikën IV. mos respektimi i këtij vendimi, detyron panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe nenit 131 të Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues. Nën pikën V. me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: NT “Sporting”-Prizren refuzohet të njëjtit operator ekonomik i bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Paneli Shqyrtues i Prokurimit Publik, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 20.09.2018, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm.

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit të paditurës dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se: nga deklaratimet e palëve gjykata vlerësoj se nuk është kontestuese se autoriteti kontraktues me datë 04.07.2018 e ka njoftuar Operatorin Ekonomik ankues lidhur me rezultatin e aktivitetit të prokurimit dhe e ka njoftuar për OE të rekomanduar për lidhje të kontratës. Ndërsa me datë 09.07.2018 ka bërë publikimin e njoftimit për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me rekuizita sportive për shkollat e Komunës së Prishtinës” me numër prokurimit: 616-18-008-1-2-1. Jo kontestuese është fakti se ekziston mospërputhje në mes të datës kur njoftimi me shkrim dorëzohet Operatorit Ekonomik (04.07.2018) dhe datës kur është bërë njoftimi i publikimit të njoftimit për dhënie të kontratës (09.07.2018) në një rast të tillë, sipas nenit 4 paragrafi 2 të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë autoriteve Kontraktuese, data e llogaritjes së afatit për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim është data kur njoftimi me shkrim i është dorëzuar Operatorit Ekonomik që është data 04.07.2018. Operatori Ekonomik ankues këtu paditësi me datë 04.07.2018 është njoftuar me letër standarde tenderues të eliminuar, kërkesa për rishqyrtim është parashtruar nga paditësi përmes e-mail me datë 16.07.2018 e cila është protokoluuar ditën e nesërme me datë 17.07.2018 ndërsa data e fundit e

lejuar për parashtrimin e kërkesës për rishqyrtim ka qenë 09.07.2018 e që i bie që kërkesa është parashtruar ditën e 13-të. Prandaj gjykata vlerëson se Paneli Shqyrtues i OSHP-së dhe autoriteti kontraktues kanë aplikuar drejtë dispozitat ligjore dhe kanë vepruar në përputhje me nenin 87, paragrafin 2, nën paragrafin 2.8 dhe nenin 118, paragrafi 1 të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr., 04/L-042 i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, dhe rregullat që plotësojnë dhe japin sqarime për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese dhe parashtrim të ankesave pranë OSHP-së, kur kanë vlerësuar se kërkesa për rishqyrtim ishte e pas afatshme, andaj bazuar në nenet 13 par.1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se e paditura drejt ka aplikuar dispozitat ligjore në përputhje me Ligjin Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe ligjin 05/L-092.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata duke vendosur me aktgjykimin e ankimuar ka bërë vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që vendimi i Panelit Shqyrtues OSHP është jo ligjor dhe e bën tërë procedurën e prukurimit tendencioze duke vërtetuar një vendim të Panelit Shqyrtues të OSHP si vendim i fundit administrativ i cili është marr bazuar në konstatimet e gabuara dhe jo të plota të fakteve të çështjes. Këto pretendime ankimore kolegji nuk i aprovoi, ngase Dhoma e Shkallës së Parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit, ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, ngase të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur dhe në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës, meqë vendimi i organit administrativ i të paditurës është në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi. Sepse, Dhoma e Shkallës së Parë me të

drejtë i është referua Ligjit për Prokurimin Publik i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092 si dhe rregullave që japin sqarime lidhur me paraqitjen e kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteve Kontraktuese. Po ashtu sa i përket pretendimit se vendimi i gjykatës Komerciale është marr me shkelje të nenit 108 paragrafi a të Ligjit për Prokurimin Publik dhe nenin 4.1 paragrafi b të rregullave të reja të parashtruara të ankesave me që rast gjykata po ti kishte zbatuar në mënyrë të drejtë këto dispozita ligjore do ta aprovonte kërkesëpadianë e paditësit NT “Sporting” duke anuluar vendimine Panelit Shqyrtues të OSHP-së nr.362/2018 datë 10.08.2018 si vendim jo ligjor i fundit i marr në procedurë administrative i cili vendim ka vërtetuar faktet ligjore sa i përket afatit të parashtrimit të kërkesës për rishqyrtim të vendimit AK për dhënie të kontratës së një operatorit të papërgjegjshëm. Kolegji këto pretendime i refuzoj si të pa bazuara pasi që Dhoma e Shkallës së Dytë njejtë si Dhoma e Shkallës së Parë vlerëson se si bazë për llogaritjen afatit për pranueshmërinë e kërkesës për rishqyrtim është data 04.07.2018 e që është dita e njoftimit të Operatorit Ekonomik ankues nga Autoriteti Kontraktues për dhënien e kontratës Operatorit Ekonomik të shpallur fitues.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Dhoma e Shkallës së Dytë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore se Dhoma e Shkallës së Parë ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës, për shkak se aktgjykimi i ankimuar ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, pasi që i njëjti është kontradiktor me vetveten dhe me arsyetimin, respektivisht arsyet e theksuara në të janë të pa qarta dhe kundërthënëse me faktet, respektivisht provat e paraqitura nga paditësi. Ky kolegji këto pretendime ankimore nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara, përkatësisht të pa argumentuara me prova konkrete, ngase sipas vlerësimit të kolegjit aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë, dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadiisë të paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura të njëpasnjëshme një aktgjykim i tillë nuk mund të

vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë**

K.DH.SH.II.nr.562/24, me datë 24.05.2024

Kryetare e kolegjit,  
Franciska Zhitija Ymeri